

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 13 numër 1 janar 2010

Data e botimit 07.02.2011

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 19.01.2011 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut operacional”” 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 04, datë 19.01.2011 “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare” 23
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 26.01.2011 “Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes” 32



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 03, datë 19.01.2011

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT
OPERACIONAL"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; dhe të nenit 57, pika 4 dhe nenit 58, pika 1, shkronja "c" dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"; dhe nenit 46 dhe nenit 47, pika 2 të ligjit nr. 8782, datë 03.05.2001 "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut operacional" dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

RREGULLORE "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL"

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave për administrimin e rrezikut operacional në veprimtarinë bankare dhe/ose financiare nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 2 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) nenit 57, pika 4 dhe nenit 58, pika 1, shkronja "c" dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet "ligji për bankat";
- c) nenit 46 dhe nenit 47, pika 2 të ligjit nr. 8782 datë 03.05.2001 "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit", i ndryshuar.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, si dhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat, dhe në ligjin nr. 8782 datë 03.05.2001 "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit", i ndryshuar.
2. Termat e përdorur në këtë rregullore "Këshill Drejtues" dhe "Drejtori", të cilët i referohen formës së organizimit juridik të bankave nuk kushtëzojnë ose kufizojnë zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje për subjektet e tjera. Këta terma në rastin e subjekteve të tjera, të cilat nuk janë të organizuara si banka, do të nënkuptojnë organet përkatëse të subjektit, të cilat ushtrojnë

funksionet analoge të “Këshillit Drejtues” dhe “Drejtorisë” në varësi të organizimit juridik të tyre.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:
 - a) “rrezik operacional” – është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Për qëllime të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut operacional, subjektet mund të përcaktojnë përkufizime më të specifikuar të këtij rreziku, me kusht që ato të përmbajnë minimalisht elementët e përkufizimit të kësaj rregulloreje;
 - b) “rrezik ligjor” – është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i moszbatimit ose zbatimit në mënyrën jo të duhur të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktuale, duke përfshirë dhe procedura të tjera ligjore të cilat mund të ndikojnë negativisht në rezultatin financiar duke mbartur rrezikun e humbjeve financiare në veprimtarinë e subjekteve;
 - c) “rrezik strategjik” – është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare si rezultat i vendimmarrjes/ve strategjike të papërshtatshme apo jo të mirëstudiuara në veprimtarinë e subjektit/eve;
 - d) “rrezik reputacional” – është mundësia që subjekti të pësojë humbje financiare të shkaktuara nga rënia e reputacionit në veprimtarinë e subjektit/eve si rrjedhojë e opinionit negativ të publikut ndaj subjektit/eve.

KREU II KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL

Neni 5 Sistemi i administrimit të rrezikut operacional

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, pavarësisht madhësisë dhe kompleksitetit të organizimit dhe veprimtarisë së tyre, krijojnë dhe zhvillojnë një sistem të brendshëm të përshtatshëm (politika, procedura, rregulla dhe teknika) për administrimin e rrezikut operacional. Ky sistem ka për qëllim të sigurojë identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin në vazhdimësi dhe tërësi të rrezikut operacional.
2. Sistemi i administrimit të rrezikut operacional të subjektit minimalisht duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

- a) përcaktimin, në funksion/varësi të madhësisë dhe veprimtarisë së tij, se çfarë përbën rrezik operacional për subjektin;
- b) tërësinë e ngjarjeve të pritshme që mund të shkaktojnë rreziqe operacionale me rëndësi materiale për subjektin (duke përfshirë ato të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje);
- c) politikat për identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin ose zbutjen e këtij rreziku, duke përfshirë dhe specifikuar (kur është e mundur) dhe kufijtë e lejuar të rrezikut operacional;
- d) veprimet më me përparësi për subjektin në procesin e administrimit të rrezikut operacional, duke përfshirë dhe shkallën dhe mënyrën e transferimit të këtij rreziku jashtë subjektit.

Neni 6

Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi përgjegjës për krijimin dhe zhvillimin e sistemit të administrimit të rrezikut operacional, të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
2. Këshilli Drejtues, në kuadër të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjës për:
 - a) miratimin e politikave dhe procedurave përkatëse për administrimin e rrezikut operacional;
 - b) ngritjen e një strukture administrimi të aftë për zbatimin e akteve rregullative të brendshme të subjektit për administrimin e rrezikut operacional;
 - c) përcaktimin e qartë të ndarjes së përgjegjësisë dhe linjave të raportimit midis funksioneve të kontrollit të rrezikut operacional, linjave të biznesit dhe funksioneve mbështetëse;
 - d) rishikimin në mënyrë periodike të akteve rregullative të subjektit për administrimin e rrezikut operacional me qëllim administrimin e rreziqeve operacionale që rrjedhin nga ndryshimet e tregut dhe faktorë të tjerë të jashtëm, si dhe ato rreziqe operacionale që lidhen me produktet, veprimtaritë ose sistemet e reja. Procesi i rishikimit duhet të synojë vlerësimin dhe përzgjedhjen e praktikave më të mira të administrimit të rrezikut operacional, të përshtatshme për veprimtaritë, sistemet dhe proceset e subjektit.
3. Këshilli Drejtues siguron që sistemi për administrimin e rrezikut operacional i nënshtrohet një procesi efektiv dhe gjithëpërfshirës të kontrollit të brendshëm nga një personel i pavarur, i kualifikuar dhe i përgjegjshëm.

Neni 7

Përgjegjësitë e Drejtorisë

1. Drejtorja është përgjegjëse për zbatimin e akteve të brendshme

rregullative për administrimin e rrezikut operacional të subjektit, të miratuara nga Këshilli Drejtues.

2. Drejtoria, në funksion të administrimit të rrezikut operacional, është përgjegjëse për:
 - a) zbatimin e politikave, proceseve dhe procedurave për administrimin e rrezikut operacional në të gjitha shërbimet/produktet, veprimtaritë, proceset dhe sistemet me rëndësi për subjektin;
 - b) zbatimin në vazhdimësi dhe nga të gjitha strukturat e subjektit të akteve të brendshme për administrimin e rrezikut operacional;
 - c) zbatimin e përgjegjësive dhe zhvillimin e linjave të raportimit për të inkurajuar dhe për të ruajtur llogaridhënien, për të siguruar burimet financiare dhe njerëzore të duhura për administrimin efektiv të rrezikut operacional;
 - d) komunikimin në mënyrë të qartë te punonjësit e të gjitha niveleve, veçanërisht në njësitë që janë të ekspozuara ndaj rrezikut operacional, të politikës së subjektit për administrimin e rrezikut operacional;
 - e) drejtimin e veprimtarisë bankare dhe/ose financiare të subjektit nga personel i kualifikuar, me përvojë, dhe aftësi teknike të nevojshme;
 - f) të siguruar që personeli përgjegjës për monitorimin e zbatimit të politikës së administrimit të rrezikut operacional, të jetë i pavarur nga njësitë që ata mbikëqyrin;
 - g) sigurimin e dokumentimit të politikave, proceseve dhe procedurave që lidhen me teknologjitë e përparuara, të cilat, në veçanti mbështesin transaksionet me vlera të larta.

KREU III ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

Neni 8 Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut operacional

1. Subjektet identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun operacional në të gjitha shërbimet/produktet, veprimtaritë, proceset dhe sistemet me rëndësi.
2. Subjektet, përpara hedhjes në treg, të shërbimeve/produkteve të reja, kryerjes së veprimtarive apo proceseve të ndryshme, dhe/ose krijimit të sistemeve të reja, sigurojnë zbatimin e procedurave të mjaftueshme dhe të përshtatshme për vlerësimin paraprak të rrezikut operacional që mund të lidhet me to.
3. Subjektet identifikojnë në mënyrë efektive rrezikun operacional duke konsideruar faktorët e brendshëm (të tillë si: struktura e

subjektit, natyra e veprimtarive, cilësia e burimeve njerëzore, ndryshimet organizative dhe qarkullimi i punonjësve) dhe faktorët e jashtëm (të tillë si: ndryshimet në industri dhe përparimet teknologjike), të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme në arritjen e objektivave të subjektit.

4. Subjektet vlerësojnë ekspozimin që ato kanë ndaj rreziqeve të identifikuar, duke përcaktuar në këtë mënyrë profilin e tyre të rrezikut me qëllim përdorimin efikas të burimeve njerëzore dhe teknike për administrimin e këtyre rreziqeve.
5. Subjektet përcaktojnë metodat dhe teknikat e tyre për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional. Aneksi 2, i kësaj rregulloreje përcakton disa nga metodat dhe teknikat që subjektet mund të përdorin për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut operacional.

Neni 9

Monitorimi dhe raportimi i rrezikut operacional

1. Subjektet zhvillojnë një proces monitorimi dhe raportimi periodik të rrezikut operacional dhe të ekspozimeve ndaj këtij rreziku, me qëllim identifikimin e shpejtë dhe plotësimin e mangësive në politikat, proceset dhe procedurat për administrimin e këtij rreziku.
2. Subjektet, në realizimin e procesit të monitorimit efektiv dhe të vazhdueshëm të rrezikut operacional duhet të:
 - a) përcaktojnë tregues të përshtatshëm që sigurojnë paralajmërim të hershëm të rritjes së rrezikut operacional i cili mund të sjellë humbje në të ardhmen;
 - b) vendosin kufij për këta tregues, kur është e mundur, me qëllim krijimin e një procesi efektiv monitorimi, që mund të ndihmojë për të identifikuar rreziqet kryesore dhe me rëndësi për subjektin dhe për t'i mundësuar këtij të fundit monitorimin në kohë të tyre;
 - c) përcaktojnë periodicitetin e procesit të monitorimit, duke marrë në konsideratë shkallën e rrezikut dhe natyrën e ndryshimeve në mjedisin në të cilin operojnë;
 - d) sigurojnë përfshirjen e rezultateve të monitorimit në raportet e rregullta për drejtorinë dhe këshillin drejtues.
3. Subjektet zbatojnë procedura të brendshme që sigurojnë raportimin e rregullt për drejtorinë dhe këshillin drejtues të administrimit të rrezikut operacional, përkatësisht nga njësitë e biznesit, nga funksioni/njësia organizative e administrimit të rrezikut operacional dhe njësia e kontrollit të brendshëm.
4. Raportet e rrezikut operacional të parashikuara në pikën 3 të

këtij neni duhet të përmbajnë si vijon:

- a) të dhëna për situatën e brendshme financiare, operacionale dhe të respektimit të kufijve të përcaktuar për treguesit e rrezikut, si dhe informacion mbi tregun në lidhje me ngjarjet të cilat janë të rëndësishme për vendimmarrjen;
 - b) një pasqyrë të plotë të çdo problemi të identifikuar dhe udhëzime për veprimet korrigjuese në çështje të pazgjidhura.
5. Subjektet sigurojnë shpërndarjen e raporteve në të gjitha nivelet e drejtimit dhe tek përfaqësuesit e linjave të biznesit të cilat ndikohen nga problematikat e ngritura në raport. Subjektet analizojnë këto raporte me qëllim përmirësimin e praktikave dhe procedurave ekzistuese dhe hartimin e politikave/praktikave dhe procedurave të reja në administrimin e rrezikut operacional.

Neni 10

Kontrolli dhe zbutja e rrezikut operacional

1. Subjektet hartojnë dhe zbatojnë politika, procese dhe procedura për të kontrolluar dhe/ose zbutur rreziqet operacionale me rëndësi materiale.
2. Subjektet, në funksion të kontrollit dhe zbutjes së rrezikut operacional:
 - a) hartojnë një sistem procedurash dhe procesesh kontrolli për të siguruar zbatimin e politikave të brendshme për administrimin e rrezikut operacional;
 - b) krijojnë një sistem të kontrollit të brendshëm efektiv me ndarje të përshtatshme të detyrave;
 - c) sigurojnë, që përveç ndarjes së detyrave, praktikat/proceset e tjera të brendshme të jenë të përshtatshme në kontrollin e rrezikut operacional, duke përfshirë:
 - i. monitorimin nga afër të respektimit të kufijve të caktuar ose kufijve të rrezikut,
 - ii. marrjen e masave mbrojtëse në përdorimin e të dhënave dhe të aktiveve të subjekteve, duke përfshirë dhe lidhjen e kontratave të sigurimit,
 - iii. sigurimin se personeli është i kualifikuar dhe ka ekspertizën e duhur,
 - iv. identifikimin e linjave të biznesit ose të produkteve, ku fitimet duket të jenë jashtë pritshmërive të arsyeshme,
 - v. heqjen dorë nga linja/t e biznesit me potencial të lartë ekspozimi dhe humbjeje për shkak të rrezikut operacional, dhe
 - vi. verifikimin dhe rakordimin e rregullt të llogarive dhe transaksioneve;

- d) përdorin mjete ose programe për uljen e ekspozimit ndaj ngjarjeve me probabilitet të ulët, por që mund të shkaktojnë ndikim të madh në rezultatin financiar të tyre;
 - e) i kushtojnë vëmendje të veçantë veprimtarive dhe/ose krijimit të produkteve të reja, sidomos kur këto të fundit nuk janë në përputhje me planin e biznesit të tyre;
 - f) i kushtojnë vëmendje të veçantë hyrjes në tregje të panjohura dhe/ose ndërmarrjes së veprimtarive tregtare gjeografikisht larg zyrës qendrore;
 - g) investojnë në përdorimin e duhur dhe sigurinë e teknologjisë së informacionit, duke treguar kujdesin e duhur në lidhje me rritjen e shkallës së automatizimit të shërbimeve;
 - h) krijojnë politika mbi administrimin e rrezikut që rrjedh nga transferimi i funksioneve dhe/ose përgjegjësive të subjektit te palët e treta.
3. Subjektet rishikojnë periodikisht politikat dhe procedurat e tyre për kontrollin dhe zbutjen e rrezikut operacional, duke synuar përdorimin e strategjive të duhura në përshtatje me profilin e tyre për këtë rrezik, si dhe me rrethanat dhe mjedisin e krijuar.

Neni 11

Plani i vazhdimësisë së aktivitetit

1. Subjektet sigurojnë plane të vazhdimësisë së aktivitetit, të cilat kanë për qëllim ushtrimin në mënyrë të pandërprerë të veprimtarive dhe kufizimin e humbjeve të lidhura me rrezikun operacional.
2. Subjektet sigurojnë që planet për vazhdimësinë e aktivitetit të jenë pjesë përbërëse e sistemit të administrimit të rrezikut operacional dhe/ose të rreziqeve të tjera.
3. Subjektet, për hartimin dhe miratimin e këtyre planeve, përcaktojnë:
 - a) veprimtaritë kryesore, vazhdimësia e të cilave duhet të sigurohet edhe në rastet e emergjencës;
 - b) skenarë/ngjarje, të cilat mund të shkaktojnë ndërprerjen e proceseve dhe/ose veprimtarive kryesore;
 - c) zgjidhje alternative për të ruajtur vazhdimësinë e ushtrimit të veprimtarive kryesore në rastet e jashtëzakonshme;
 - d) veprime për të rivendosur funksionimin e rregullt të veprimtarive, veçanërisht për të siguruar informacionin e sistemeve elektronike dhe kthimin e këtyre sistemeve në gjendje funksionale;
 - e) strategjitë e komunikimit në rastet e problemeve serioze dhe/ose ndërprerjeve të veprimtarive.
4. Subjektet shqyrtojnë dhe/ose rishikojnë periodikisht planet për sigurimin e vazhdimësisë së veprimtarisë, në mënyrë që ato të

jenë në përputhje me veprimtaritë aktuale dhe strategjitë e tyre të biznesit.

KREU IV RAPORTIMI DHE MBIKËQYRJA

Neni 12 Raportimi në Bankën e Shqipërisë

Subjektet raportojnë në Bankën e Shqipërisë përkatësisht çdo vit dhe çdo tremujor të dhënat sipas anekseve 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 13 Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat dhe në ligjin "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit.

KREU V

Neni 14 Dispozitë kalimtare

Subjektet e kësaj rregulloreje plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 15 Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

ANEKSI 1

NGJARJET E RREZIKUT OPERACIONAL QË MUND TË SHKAKTOJNË HUMBJE TË RËNDËSISHME

Lloji i ngjarjes	Përkufizimi
Mashtrimi i brendshëm	Mashtrimi i brendshëm lidhet me ushtrimin e veprimtarive të paautorizuara, vjedhje dhe/ose mashtrime që përfshijnë të paktën një punonjës të subjektit. Disa ngjarje të cilat klasifikohen si mashtrime të brendshme jepen më poshtë: a) raportime të gabuara dhe me dashje në lidhje me pozicionet e subjektit; b) kryerje e transaksioneve të paautorizuara të subjektit; c) transaksione të brendshme (nën llogarinë e punonjësit të subjektit); d) shkatërrim i qëllimshëm i aktiveve të subjektit; e) vjedhje, grabitje, zhvatje, përvetësime në subjekt; f) falsifikime; g) evazion fiskal i qëllimshëm.
Mashtrimi i jashtëm	Mashtrimi i jashtëm i referohet mashtrimeve dhe/ose vjedhjeve që kryhen nga një palë e tretë jashtë subjektit. Ky përfshin ndër të tjera: a) vjedhjet dhe grabitjet; b) falsifikimet; c) dëmtimet e qëllimshme të sistemeve kompjuterike (<i>Hacking damage</i>); d) vjedhjet e informacionit; e) etj.
Praktikat e punësimit dhe të sigurisë në punë	Kjo kategori i referohet ngjarjeve që lidhen me marrëdhëniet e punonjësve, sigurisë së mjediseve të punës si dhe diversitetit/diskriminimit. Shembuj të cilët mund të sjellin humbje operationale, përfshijnë: a) kompensimin e pretendimeve të punonjësve (shembull: ngjarjet e diskriminimit etj.); b) përfundimin e gabuar (të padrejtë) të kontratës/ave të punësimit; c) shkeljet e rregullave të shëndetit dhe sigurisë.
Klientët, produktet dhe praktika të veprimtarive	Në këtë kategori, humbjet operationale lindin si pasojë e një dështimi për të përmbushur një detyrim të klientit, ose nga natyra dhe projektimi i produktit. Shembuj të këtyre ngjarjeve, ndër të tjera përfshijnë: a) shkelje të detyrave të besuara (në mirëbesim); b) keqpërdorim i informacionit konfidencial të klientit; c) pastrim parash; d) defekte të produkteve; e) tejkalim i të drejtave të aksesit në programin kompjuterik bankar bazë; f) gabime njerëzore ose të llogaritjeve automatike; g) tejkalim të kufijve të ekspozimit ndaj klientit.
Dëmtime fizike të aktiveve	Kjo kategori përfshin humbjet si pasojë e fatkeqësive dhe/ose veprimeve të tjera, të tilla si: a) katastrofa natyrore, të cilat përfshijnë (tërmete, zjarr, përmytje etj.); b) terrorizëm; c) vandalizma.
Ndërprerja e aktivitetit dhe dështimi i sistemeve	Ngjarjet e rrezikut operational në këtë kategori përfshijnë, ndër të tjera: a) dështimin e plotë ose të pjesshëm të pajisjeve ose programeve; b) probleme të telekomunikacionit; c) ndërprerje të shërbimeve; d) vjetrim të pajisjeve.
Ekzekutimi, shpërndarja dhe administrimi i proceseve	Kjo kategori përfshin ngjarjet e rrezikut që lidhen me përpunimin e transaksioneve ose me administrimin e proceseve dhe të marrëdhënieve me palë të treta. Shembuj të ngjarjeve të tilla, ndër të tjera përfshijnë: a) mangësi në komunikim; b) gabime në hedhjen e të dhënave (shembull: të dhëna të gabuara); c) mosrespektimi i afateve ose përgjegjësisë; d) keqfunksionim i moduleve/sistemeve; e) gabime në kontabilitet; f) gabime në raportim; g) mangësi në dokumentacionin ligjor; h) hyrje e paaprovuar në llogarinë e klientit; i) mosmarrëveshje me palët e treta; j) mosfunksionim i kontratave të shërbimit me palë të treta sipas kushteve dhe termave të rëna dakord.

ANEKSI 2

METODAT DHE TEKNIKAT E ZAKONSHME PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL NGA SUBJEKTET, PËRFSHIJNË KRYESISHT:

1. Vlerësimin e rrezikut. Subjektet vlerësojnë operacionet dhe veprimtaritë e tyre kundrejt dobësive potenciale të rrezikut operacional. Ky proces është i brendshëm dhe shpesh përfshin lista kontrolluese, fletë vlerësuese (*scorecards*), mbledhje pune për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të mjedisit të rrezikut operacional.
2. *Risk Mapping*. Në këtë proces, njësi të ndryshme të aktivitetit, funksione organizative ose rrjedha e procesit kategorizohen (*mapping*) sipas llojit të rrezikut. Ky proces mund të identifikojë dobësitë në fusha të ndryshme dhe ndihmon në përcaktimin e prioriteteve në veprimet që do të ndërmarrë administrimi në të ardhmen.
3. Treguesit e rrezikut. Treguesit e rrezikut kryesisht janë tregues statistikorë, shpesh financiarë, të cilët mund të sigurojnë informacione mbi pozicionin e rrezikut të subjekteve dhe duhet të rishikohen në baza periodike.
4. Matja. Për përcaktimin/matjen e vlerave të ekspozimit ndaj rrezikut operacional përdoren një sërë metodash. Për shembull: të dhënat historike mbi ecurinë e veprimtarisë së subjekteve mund të japin informacione për vlerësimin e ekspozimit të tyre ndaj rrezikut operacional dhe zhvillimin e politikave për të zbutur dhe kontrolluar këtë të fundit. Një mënyrë efektive për të përdorur këtë informacion është krijimi i një sistemi për ndjekjen sistematike dhe regjistrimin e frekuencave, ashpërsisë së ngjarjeve dhe informacione të tjera të rëndësishme mbi ngjarjet e humbjeve individuale. Subjektet mund të kombinojnë të dhënat e brendshme të humbjeve me të dhënat e humbjeve nga jashtë, të realizojnë analiza mbi bazën e skenarëve dhe të faktorëve të vlerësimit të rrezikut.

ANEKSI 3

PARIMET MBI MBLEDHJEN DHE DOKUMENTIMIN E TË DHËNAVE

Në mbledhjen dhe dokumentimin e të dhënave për humbjet nga rreziku operacional subjektet zbatojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Subjektet duhet të jenë në gjendje të kategorizojnë (*mapping*) të dhënat historike të humbjeve të brendshme sipas linjave të biznesit me llojet e ngjarjeve. Kategorizimi i humbjeve sipas linjave të biznesit dhe llojit të ngjarjeve bëhet duke përdorur kritere objektive dhe të dokumentuara.
2. Të dhënat për humbjet e brendshme të bankës duhet të jenë gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të përfshijnë të gjitha veprimtaritë dhe ekspozimet me rëndësi për subjektin/et. Subjektet duhet të jenë në gjendje të justifikojnë se çdo veprimtari apo ekspozim i përjashtuar, qoftë në mënyrë individuale apo dhe ato që janë në bashkëveprim, nuk do të kishin një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut. Për mbledhjen e të dhënave që lidhen me humbjet e brendshme duhen përcaktuar kufij minimalë të përshtatshëm.
3. Subjektet, përveç informacionit mbi vlerën bruto të humbjeve, duhet të mbledhin informacion mbi çdo rikuperim të vlerës bruto të humbjes, si dhe një informacion përshkrues rreth shkaqeve të ngjarjes.
4. Subjektet, për caktimin e të dhënave mbi humbjet, që burojnë nga një ngjarje në një funksion apo veprimtari të veçantë që shtrihet në më shumë se një linjë biznesi, duhet të përdorin kritere specifike.

ANEKSI 4

KLASIFIKIMI I LINJAVE TË BIZNESIT

Nr.	Linjat e biznesit	Lista e veprimtarive
1.	Financat e korporatave	<ul style="list-style-type: none"> nënshkrimin e instrumenteve financiare dhe / ose vendosjen e instrumenteve financiare në baza të një angazhimi të pakthyesëm; shërbime të lidhura me nënshkrimin; shërbime këshilluese në fushën e investimeve; shërbime këshilluese mbi strukturën e kapitalit, strategjinë e biznesit dhe aspekte të lidhura me to, si edhe shërbime këshilluese dhe shërbime të lidhura me shkrirjen dhe blerjen e shoqërive (ndërmarrjeve); analiza kërkimore dhe financiare mbi investimet dhe forma të tjera të përgjithshme të këshillimit lidhur me transaksionet me instrumente financiare.
2.	Veprime me thesarin	<ul style="list-style-type: none"> tregtimi për llogari të vet; ndërmjetësimi në tregjet ndërbankare; marrje dhe transmetim i urdhrave lidhur me një ose më shumë instrumente financiare; ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve; vendosje e instrumenteve financiare jo në baza të një angazhimi të pakthyesëm; administrimi i një sistemi shumëpalësh transaksionesh (<i>Operation of Multilateral Trading Facilities</i>).
3.	Ndërmjetësim me pakicë	<ul style="list-style-type: none"> marrja dhe transmetimi i urdhrave lidhur me një ose më shumë instrumente financiare; ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve; vendosje e instrumenteve financiare jo në baza të një angazhimi të pakthyesëm.
4.	Veprimtari bankare dhe financiare	<ul style="list-style-type: none"> pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme; kredidhënie; qira financiare; ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve.
5.	Veprimtari bankare me pakicë (<i>retail</i>)	<ul style="list-style-type: none"> pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme; kredidhënie; qira financiare; ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve.
6.	Pagesa dhe shlyerje	<ul style="list-style-type: none"> shërbimi i pagesave dhe transferimit të parave (fondeve); lëshimi dhe administrimi i mjeteve të pagesave.
7.	Shërbime si agjent	<ul style="list-style-type: none"> ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare për llogari të klientëve, duke përfshirë marrjen në kujdestari dhe shërbime të lidhura me to të tilla si: administrimi i cash-it ose i garancive reale (kolateralit).
8.	Administrim aktivesh	<ul style="list-style-type: none"> administrimi i portofolit; administrimi i titujve të sipërmarrjeve kolektive të investimit (<i>Managing of UCITS</i>); forma të tjera të administrimit të aktiveve.

ANEKSI 5

PARIMET (KËRKESAT) PËR KATEGORIZIMIN E LINJAVE TË BIZNESIT

Subjektet duhet të hartojnë politika dhe kritere të veçanta për kategorizimin e treguesve respektivë për linjat dhe veprimtaritë e biznesit në një kuadër të standardizuar. Kriteret duhet të rishikohen dhe të përshtaten për aktivitetet e reja apo/dhe për çdo ndryshim të biznesit dhe të rreziqeve, që ndërmerr subjekti/et. Parimet për kategorizimin e linjave të biznesit janë:

1. Të gjitha veprimtaritë duhet të kategorizohen/përfshihen plotësisht në 8 linjat e biznesit të përcaktuara në aneksin 4.
2. Çdo veprimtari e cila nuk mund të kategorizohet lehtë në kuadrin e linjave të biznesit, por që përbën një funksion ndihmës për një veprimtari të përfshirë në këtë kuadër linjash, duhet të përfshihet në atë linjë biznesi që mbështet. Subjektet duhet të vendosin kritere objektive për kategorizimin e veprimtarive, në rastin kur veprimtaria ndihmëse mbështet më shumë se një linjë biznesi.
3. Nëse një veprimtari nuk mund të kategorizohet në një linjë të veçantë biznesi, subjekti duhet të përdorë njërën nga linjat e biznesit siç veprohet në rastin e veprimtarive ndihmëse.
4. Kategorizimi i veprimtarive në linjat e biznesit, për qëllime të rrezikut operacional, duhet të jetë në përputhje me kategoritë e përdorura për klasifikimin e aktiveve sipas rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tregut.
5. Procesi i kategorizimit të veprimtarive sipas linjave të biznesit duhet të jetë subjekt i shqyrtimit të pavarur të kontrollit të brendshëm.

ANEKSI 6

RREZIKU OPERACIONAL: HUMBJET BRUTO SIPAS LINJAVE TË BIZNESIT DHE LLOJEVE TË NGJARJEVE GJATË VITIT TË FUNDIT

KATEGORIZIMI I HUMBJEVE ME LINJAT E BIZNESIT		LLOJI I NGJARJEVE							Totali për llojin e ngjarjeve	Kufijtë e përdorur për mbledhjen e të dhënave	
		Mashtrim i brendshëm	Mashtrim i jashtëm	Praktikat e punësimit dhe të sigurisë në punë	Klientët, produktet dhe praktikat e biznesit	Dëmtim fizik i aktiveve	Ndërprerje e biznesit dhe avari e sistemeve	Ekzekutimi, shpërndarja & administrimi i proceseve		Niveli më i ulët	Niveli më i lartë
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
FINANCAT E KORPORATAVE	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
VEPRIME ME THESARIN	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
NDËRMJETËSIM ME PAKICË	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
VEPRIMTARI BANKARE E FINANCIARE	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
VEPRIMTARI BANKARE ME PAKICË	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
PAGESAT DHE SHLYERJET	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
SHËRBIME SI AGJENT	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										
TOTALI PËR LINJAT E BIZNESIT	Numri i ngjarjeve										
	Sasia totale e humbjeve										
	Humbja maksimale										

Shënim: Kuadratet e fleksuar në tabelë nuk plotësohen nga subjekti.

Udhëzime, komente dhe referenca rregullatore për tabelën më sipër (Aneksi 6).

NR	ETIKETA	Udhëzime, komente dhe referenca rregullatore
KOLONAT		
1-7	Përkufizimi i llojeve të ngjarjeve	Rregullorja "Për standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional", Aneksi 1
8	Totali për llojin e ngjarjeve	Për çdo linjë biznesi, shifrat janë një agregim i thjeshtë (numri i ngjarjeve dhe sasia totale e humbjeve) ose maksimumi (humbja maksimale) i të dhënave sipas llojeve të ngjarjeve. Ekziston një rast i veçantë për të dhënat mbi disa ngjarje dhe humbjen maksimale për "Totali për linjat e biznesit" (Shih shpjegimin më poshtë "Numri i Ngjarjeve")
	Kufijtë e përdorur për mbledhjen e të dhënave	Rregullorja "Për standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional" aneksi 3, pika 2
9,10	Niveli më i ulët / niveli më i lartë	Rregullorja "Për standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional" aneksi 3, pika 2 Nëse ekziston vetëm një kufi për të gjitha ngjarjet në çdo linjë biznesi, duhet plotësuar vetëm kolona: niveli më i ulët. Nëse ekzistojnë kufij të ndryshëm që përdoren brenda të njëjtës linjë biznesi, atëherë duhen plotësuar të dyja kolonat.
RRESHTAT		
	Përkufizimi i linjave të biznesit	Rregullorja "Për standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional", Aneksi 4
	Kategorizimi i humbjeve me linjat e biznesit	Rregullorja "Për standardet minimale të administrimit të rrezikut operacional" aneksi 3, pikat 1 dhe 2. Informacioni i mëposhtëm që kërkohet për çdo linjë biznesi duhet të raportohet sipas kufijve të përdorur (shih shpjegimin më sipër "Kufijtë e përdorur për mbledhjen e të dhënave").
	Numri i ngjarjeve	Numri i ngjarjeve të regjistruara në çdo linjë biznesi. Nëse një ngjarje ka ndikim mbi disa linja biznesi, duhet raportuar në të gjitha ato linja ku evidentohet humbje mbi një nivel të caktuar. Gjithashtu, numri total i ngjarjeve për "Totali i linjave të biznesit" dhe "Totali i llojit të ngjarjeve" do të jetë më i ulët se agregimi i ngjarjeve sipas linjave të biznesit, pasi ato ngjarje me ndikim të shumëfishtë do të konsiderohen vetëm si një.
	Sasia totale e humbjeve	Agregimi i humbjeve të regjistruara në bazën e të dhënave për çdo linjë biznesi dhe sipas rastiit, e ndarë sipas llojit të ngjarjes.
	Humbja maksimale	Humbja maksimale e regjistruar sipas linjës së biznesit. Në rastin e humbjes maksimale për "Totali për linjat e biznesit" dhe "Totali për llojet e ngjarjeve", ato ngjarje me ndikim në linja të ndryshme biznesi duhet të konsiderohen si një e vetme.
	Totali për linjat e biznesit	Për çdo lloj ngjarjeje, shifrat janë: - Numri i ngjarjeve mbi nivelin e përcaktuar sipas llojit të ngjarjes për "totalin për linjat e biznesit". Kjo shifër mund të jetë më e ulët se agregimi i numrit të ngjarjeve sipas linjave të biznesit, pasi këtu ato ngjarje me ndikim të shumëfishtë do të konsiderohen vetëm si një. - Sasia totale e humbjeve është agregimi i thjeshtë i sasisë totale të humbjeve për çdo linjë biznesi. - Humbja maksimale është humbja maksimale mbi nivelin e përcaktuar për çdo lloj ngjarjeje dhe për totalin për linjat e biznesit.

ANEKSI 7

FORMULARI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE KYÇ TË RREZIKUT OPERACIONAL

Subjekti:
Pozicioni:
Personi përgjegjës:
Data e raportimit:

Nr.	Treguesi	Vlera	Komente
1	Çështje ligjore-A		
2	Çështje ligjore-B		
3	Ankesa të klientit-A		
4	Ankesa të klientit-B		
5	Ankesa të autoriteteve-A		
6	Ankesa të autoriteteve-B		
7	Qarkullim i punonjësve		
8	Avari/Ndërprerje të programit bazë të bankës		
9	Veprimet e dyshimta me kartat		
10	Diferencat në balancën e arkëtarëve		
11	Diferencat në balancën e arkëtarëve		

Detajime dhe sqarime për formularin e mësipërm (Aneksi 7):

Treguesit kyç të rrezikut					
Nr	Emërtimi	Përshkrim	Lloji	Formati	Frekuenca e raportimit
1	Çështje ligjore-A	Numri i çështjeve ligjore të ngritura kundër bankës nga klientët apo palë të tjera gjatë tremujorit paraardhës. Përfshin procese gjyqësore si dhe çdo lloj veprimi ligjor të ndërmarrë kundër bankës, që mund të përfundojë në gjykatë. Përfshihen çështjet gjyqësore që lidhen me përpjekjet e bankës për të rikuperuar kreditë me probleme apo çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Numërim	Tremujore
2	Çështje ligjore-B	Kostoja e çështjeve ligjore (të përcaktuara nga treguesi 1) të ngritura kundër bankës nga klientët apo palë të tjera gjatë tremujorit paraardhës. Përfshihen çështjet gjyqësore që lidhen me përpjekjet e bankës për të rikuperuar kreditë me probleme apo çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Vlerë monetare	Tremujore
3	Ankesa të klientit-A	Numri i ankesave formale të ngritura kundër bankës nga klientët, grupet e klientëve apo publiku, gjatë tremujorit paraardhës. Përfshin të gjitha ankesat e marra gjatë tremujorit paraardhës qofshin ato të mbyllura, të refuzuara apo të hapura në fund të muajit paraardhës. Përfshihen ankesat që lidhen me çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Numërim	Tremujore
4	Ankesa të klientit-B	Numri i ankesave formale të ngritura kundër bankës nga klientët, grupet e klientëve apo publiku, që rezultojnë ende të hapura në përfundim të tremujorit paraardhës. Përfshihen ankesa që lidhen me çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Numërim	Tremujore
5	Ankesa të autoriteteve-A	Numri i ankesave formale të ngritura kundër bankës nga autoritetet zyrtare (Avokati i Popullit, rregullatorët, ministritë etj.) gjatë tremujorit paraardhës, të cilat mund të finalizohen me gjobë ose jo. Përfshihen të gjitha ankesat e marra gjatë tremujorit paraardhës qofshin të mbyllura, të refuzuara apo të hapura. Përfshihen ankesat që lidhen me çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Numërim	Tremujore
6	Ankesa të autoriteteve-B	Numri i ankesave formale të ngritura kundër bankës nga autoritetet zyrtare (Avokati i Popullit, rregullatorët, ministritë etj.), të cilat rezultojnë ende të hapura gjatë tremujorit paraardhës. Përfshihen ankesat që lidhen me çështje të Burimeve Njerëzore me punonjësit.	Ndërveprim Klient/ Kundërparti	Numërim	Tremujore

7	Qarkullimi i punonjësve*	Përqindja e qarkullimit të punonjësve të të gjitha kategorive që nga fillimi i vitit deri në fund të tremujorit paraardhës. Përfshihen punonjësit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Përfshihen palët e brendshme që veprojnë si agjentë apo kontraktorë.	Njerëz	Përqindje	Tremujore
8	Avari/ Ndërprerje të programit bazë të bankës	Kohëzgjatja, e shprehur si përqindje, e ndërprerjeve të paplanifikuara të programit bazë të bankës gjatë tremujorit paraardhës (Periudha e punës matet mbi baza 24-orëshe).	Sisteme	Përqindje	Tremujore
9	Veprimet e dyshimta me kartat	Përqindja e kartave të raportuara si të humbura/të vjedhura ose që janë nën një hetim të justifikuar për shkak të arsyeve të mashtrimit që lidhen me to gjatë tremujorit paraardhës, ndaj numrit total të kartave të lëshuara nga banka për klientët e saj. (Të gjitha llojet e kartave).	Sisteme	Përqindje	Tremujore
10	Diferencat në balancën e arkëtarëve	Numri total i diferencave të arkëtarëve (deficite & suficite) gjatë tremujorit paraardhës.	Përpunim	Numërim	Tremujore
11	Diferencat në balancën e arkëtarëve	Sasia totale e diferencave të arkëtarëve (deficite & suficite) gjatë tremujorit paraardhës.	Përpunim	Vlerë monetare	Tremujore

$$* Q = L / (P) * 100, (P) = (P0 + P1) / 2$$

Ku:

Q – qarkullimi i punonjësve;

L – numri i punonjësve të larguar gjatë periudhës së raportimit;

(P) – numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës së raportimit;

P0 – numri i punonjësve në fillim të periudhës;

P1 – numri i punonjësve në fund të periudhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 04, datë 19.01.2011

PËR
KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË NË AMBIENTET NË TË CILAT
KRYHEN VEPRIMTARITË BANKARE DHE FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Sigurimit dhe të Mbrojtjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja "Për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë të mjediseve në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 91, datë 24.12.2008, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

KRYETARI

YLLI MEMISHA

ARDIAN FULLANI

RREGULLORE

“PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË NË AMBIENTET NË TË CILAT KRYHEN VEPRIMTARITË BANKARE DHE FINANCIARE”

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale të sigurisë për ambientet në të cilat ushtrohen veprimtaritë bankare dhe/ose financiare, me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.

Neni 2 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 70, pika 1, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të neneve 57 pika 2, 58 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja, zyrat e këmbimit valutor, dhe subjektet financiare jobanka që kryejnë veprimtari bankare dhe/ose financiare me sportel, si edhe agjentët e tyre.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
2. “Agjent” - ka të njëjtin kuptim me termin e përkufizuar në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 4 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 11, datë 25.02.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) "Sportel" - quhet ndarja, e cila bën të mundur krijimin e një distance sigurie ndërmjet zonës së arkëtarëve dhe zonës së klientëve;
- b) "Zona e arkëtarëve" - është ambienti i subjektit, i cili shërben si vendqëndrim i arkëtarëve;
- c) "Zona e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare" - është zona, në brendësi të ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj në të cilën vendoset kasaforta;
- d) "Kushtet për sigurinë" përfshijnë:
 - i. kushtet për mbrojtjen fizike,
 - ii. kushtet për mbrojtjen me personel, si dhe
 - iii. kushtet për mbrojtjen elektronike;
- e) "Sigurimi i jashtëm"- është shërbimi me personel që kryhet jashtë ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj;
- f) "Sigurimi i brendshëm" - është shërbimi me personel që kryhet brenda ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj;
- g) "Shoqëria e ruajtjes dhe e sigurisë fizike (SHRSF)" - është shoqëria e krijuar, licencuar dhe që funksionon sipas kërkesave të Ligjit nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar;
- h) "Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMNZSH)" - është organ shtetëror i specializuar që funksionon në bazë të Ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin".

KREU II KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË PËR AMBIENTET E BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA

Neni 5 Procedurat për kushtet teknike dhe të sigurisë

1. Banka ose dega e bankës së huaj harton dhe miraton procedura për kushtet teknike dhe të sigurisë.
2. Banka ose dega e bankës së huaj ka në strukturën e saj organizative një njësi të veçantë për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e procedurave për kushtet teknike dhe të sigurisë.
3. Në degët dhe agjencitë bankare caktohet një punonjës, që përveç detyrës që kryen, është përgjegjës për zbatimin e procedurave për kushtet teknike dhe të sigurisë.
4. Banka dhe dega e bankës së huaj, rishikon në mënyrë periodike dhe përditëson procedurat për kushtet teknike dhe të sigurisë.

Neni 6

Kushte të përgjithshme teknike për ambientet e punës së bankës dhe degës së bankës së huaj

1. Banka dhe dega e bankës së huaj, ushtron veprimtaritë në ambiente, të cilat plotësojnë minimalisht kërkesat e mëposhtme:
 - a) kanë hapësirat e nevojshme dhe kushte të përshtatshme të temperaturës, të dritës dhe të lagështirës për punonjësit, për klientët, për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe të vlerave monetare;
 - b) kanë miratimin nga PMNZSH për masat e marra kundër zjarrit;
 - c) kanë plan evakuimi në raste emergjence;
 - d) janë lehtësisht të arritshme nga njësitë e specializuara të sigurisë dhe të mbrojtjes;
 - e) kanë qartësisht të ndara këto zona:
 - i. zona e pritjes së klientit,
 - ii. zona e arkëtarëve,
 - iii. zona e ruajtjes së vlerave monetare fizike,
 - iv. zona ku vendosen sistemet e teknologjisë dhe informacionit;
 - f) janë të pajisura me një burim të dytë dhe të vazhdueshëm të energjisë elektrike.
2. Bankat dhe degët e bankave të huaja njoftojnë Komisariatin e Policisë në rrethet ku do të hapen degët dhe/ose agjencitë e reja.
3. Bankat dhe degët e bankave të huaja lidhin kontratë me SHRSF-të për:
 - a) marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit (Licencë e kategorisë "a+b");
 - b) sigurimin e jashtëm ose të brendshëm (Licencë e kategorisë "a + b");
 - c) transportin e vlerave monetare (Licencë e kategorisë "c").

Neni 7

Kushtet për zonën e arkëtarëve

1. Zona e arkëtarëve të bankave dhe degëve të bankave të huaja duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme të sigurisë:
 - a) të jetë e vendosur në një ambient të veçantë dhe të ndarë nga zonat e tjera nëpërmjet "Sportelit";
 - b) të jetë e monitoruar me telekamera;
 - c) të ketë butona ose pedana alarmi në secilin vend pune të arkëtarëve; dhe
 - d) të ketë minikasaforta ose sirtarë të posaçëm për mbajtjen e vlerave monetare.

Neni 8

Kushtet për zonën e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare

1. Bankat ose degët e bankave të huaja plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë për zonën e ruajtjes dhe administrimit të vlerave monetare:
 - a) të jetë në një vend të sigurt, plotësisht të ndarë nga zonat e tjera të bankës ose degës së bankës së huaj;
 - b) të ketë mbrojtje elektronike me:
 - i. sensorë sizmikë,
 - ii. sensorë lëvizjeje,
 - iii. sensorë tymi;
 - c) të ketë sistem monitorimi me telekamera për:
 - i. hyrjen për në këtë zonë,
 - ii. ambientin e brendshëm.

Neni 9

Kushtet për zonën ku vendosen sistemet e teknologjisë së informacionit

1. Sistemet e teknologjisë dhe të informacionit vendosen në një zonë të veçantë dhe në brendësi të ambienteve të bankës ose degës së bankës së huaj.
2. Bankat ose degët e bankave të huaja plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë për zonën ku vendosen sistemet e teknologjisë dhe të informacionit:
 - a) të jetë një zonë plotësisht e ndarë nga ambientet e tjera të bankës ose degës së bankës së huaj;
 - b) të ketë mbrojtje elektronike me:
 - i. sensorë lëvizjeje,
 - ii. sensorë tymi,
 - iii. sensorë lagështire;
 - c) të ketë sistem monitorimi me telekamera për:
 - i. hyrjen për në këtë zonë,
 - ii. ambientin e brendshëm të saj.

Neni 10

Kushtet për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike

1. Bankat ose degët e bankave të huaja marrin masa për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

2. Bankat ose degët e bankave të huaja, për mbrojtjen me anë të pajisjeve elektronike të ambienteve, plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë:
 - a) kanë telekamera të cilat filmojnë në mënyrë të pandërprerë:
 - i. sipërfaqet e jashtme të fasadës së bankës ose degës së bankës së huaj,
 - ii. hyrjen për në ambientin e brendshëm,
 - iii. zonën e klientit,
 - iv. sportelin;
 - b) kanë pajisje të veçantë dixhitale për regjistrimin e pamjeve, e cila:
 - i. vendoset në një ambient të sigurt, duke përjashtuar zonën e ruajtjes së vlerave monetare,
 - ii. koha e ruajtjes së regjistrimeve të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;
 - c) kryejnë monitorim të zonave të bankës ose degës së bankës së huaj, në rastet kur nuk ka pamje të drejtpërdrejtë të tyre, nga:
 - i. zyra e drejtuesit të tyre, ose
 - ii. zyra e përgjegjësit për sigurinë;
 - d) kanë mbrojtje elektronike me:
 - i. sensorë lëvizjeje,
 - ii. sensorë tymi,
 - iii. sensorë të lagështirës,
 - iv. butona alarmi të montuar në zyrën e drejtuesit të tyre ose në zyrën e punonjësit përgjegjës për sigurinë,
 - v. sirenë alarmi e brendshme,
 - vi. sirenë alarmi e jashtme;
 - e) kanë kombinator telefonik për dërgimin e sinjalit të alarmit në:
 - i. komisariatit e Policisë së Shtetit; ose
 - ii. sallën operatore të SHRSF-së që mbron bankën ose degën e bankës së huaj, ose
 - iii. qendrën operatore të vetë bankës ose degës së bankës së huaj.

Neni 11

Kushtet për mbrojtjen me personel

1. Bankat ose degët e bankave të huaja marrin masa për mbrojtjen me personel të ambienteve në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

2. Mbrojtja me personel i ambienteve të bankave ose degëve të huaja përfshin:
 - a) sigurimin e jashtëm, i cili kryhet si më poshtë:
 - i. sigurimi i jashtëm në degën e bankës, gjatë orarit të punës, kryhet me punonjës shërbimi të SHRSF-së, të licencuar nga Ministria e Brendshme për kategoritë "a" dhe "b" ("a+b"),
 - ii. sigurimi i jashtëm, në agjencinë e bankës vendoset ose jo në varësi të nivelit të rrezikut të perceptuar nga ana e njësisë së veçantë të parashikuar në nenin 5, pika 2 të kësaj rregulloreje;
 - b) sigurimi i brendshëm, në degët dhe agjencitë gjatë orarit të punës, vendoset ose jo në varësi të nivelit të rrezikut të perceptuar dhe kryhet me:
 - i. punonjës të sigurimit të brendshëm të vetë bankës ose degës së bankës së huaj, ose
 - ii. punonjës shërbimi të SHRSF-së.

Neni 12

Kërkesat për transportin e vlerave monetare

1. Bankat ose degët e bankave të huaja marrin masa për transportimin në mënyrë të sigurtë të vlerave monetare.
2. Transportimi i vlerave monetare realizohet në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", i ndryshuar, si edhe të akteve të miratuara në zbatim të tij.
3. Transporti i vlerave monetare realizohet me punonjës shërbimi të SHRSF-së, me licencë të kategorisë "c".

KREU III

KUSHTET MINIMALE TË SIGURISË NË AMBIENTET E ZYRAVE TË KËMBIMIT VALUTOR, SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA QË KRYEJNË VEPRIMTARI ME SPORTELE, DHE AGJENTËVE TË TYRE

Neni 13

Kushtet minimale të sigurisë së ambienteve

1. Zyrat e këmbimit valutor, subjektet e tjera financiare jobanka që kryejnë veprimtari financiare me sportel, si dhe agjentët e tyre ushtrojnë veprimtarinë në ambiente që plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë:
 - a) janë lehtësisht të arritshme nga njësitë e specializuara të sigurisë dhe të mbrojtjes;
 - b) kanë hapësirat e nevojshme, dhe kushte të përshtatshme të

temperaturës, dritës dhe të lagështisë për punonjësit, klientët, si dhe për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe vlerave monetare;

c) kanë qartësisht të ndara këto zona:

- i. zona e pritjes së klientit,
- ii. zona e arkëtarëve;

Në rastet kur veprimtaria financiare zhvillohet në ambiente publike, pika "i" e kësaj shkronje mund të mos zbatohet.

d) zona e arkëtarëve plotëson kushtet e mëposhtme:

- i. është e vendosur në një ambient të veçantë dhe të kufizuar nga zonat e tjera me "Sportel",
- ii. vlerat monetare mbahen të vendosura në minikasaforta,
- iii. është e monitoruar me telekamera.

2. Zyrat e këmbimit valutor, subjektet e tjera financiare jobanka që kryejnë veprimtari financiare me sportel, si dhe agjentët e tyre, kanë sistem monitorimi i cili përbëhet nga:

- a) telekamerat, të cilat filmojnë në mënyrë të pandërprerë të gjitha ambientet e subjektit;
- b) pajisje dixhitale për regjistrimin e pamjeve, e cila:
 - i. vendoset brenda zonës së arkëtarëve, dhe
 - ii. koha e ruajtjes së regjistrimeve, të jetë jo më pak se 5 (pesë) ditë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14 Mbikëqyrja

1. Banka e Shqipërisë kryen inspektimin në vend për zbatimin nga subjektet të kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Në fillim të çdo viti kalendarik, bankat ose degët e bankave të huaja, paraqesin në Bankën e Shqipërisë informacionin për :
 - a) kontratat e lidhura me SHRSF-të për :
 - i. marrjen dhe verifikimin e sinjalit të alarmit,
 - ii. sigurimin e jashtëm ose të brendshëm,
 - iii. transportin e vlerave monetare;
 - b) licencat (fotokopje) e kategorisë "a + b" dhe "c" të SHRSF – ve me të cilat kanë lidhur kontratë;
 - c) listën e automjeteve të blinduara për sigurimin e lëvizjes së vlerave

- monetare, targa, tipin, drejtuesin e automjetit të blinduar si dhe një kopje të autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për këto automjete;
- d) listën e punonjësve të shërbimit të SHRSF-ve, të miratuar nga Drejtoritë e Policisë së Qarqeve;
 - e) kontratën e sigurimit të vlerave monetare fizike, të lidhur me shoqërinë e sigurimit.
3. Subjektet njoftojnë Bankën e Shqipërisë në rast të ndryshimit të vendndodhjes së ambienteve ku zhvillojnë veprimtarinë bankare dhe/ose financiare me sportel.
 4. Banka e Shqipërisë, pas marrjes së njoftimit për ndryshimin, kryen inspektimin e ambienteve të reja lidhur me plotësimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.
 5. Subjektet financiare jobanka që kryejnë veprimtari me sportel nëpërmjet agjentëve janë përgjegjës për verifikimin e zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje nga këta të fundit.

Neni 15

Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 06, datë 26.01.20

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 5, 00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta).
2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

YLLI MEMISHA

KRYETARI

ARDIAN FULLANI

Banka e Shqipërisë
Sheshi "Avni Rustemi", nr. 24, Tiranë
Tel: + 355 4 241 93 01 / 02 / 03; + 355 4 241 94 09/10/11
Fax: + 355 4 241 94 08
E-mail: public@bankofalbania.org
www.bankofalbania.org
Tirazhi: 350 kopje
Shtypur në shtypshkronjën *AdeI*PRINT.